



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEKNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE AND TECHNOLOGY

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:	Arbërie Nagavci Ministre e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Prof. asoc. dr. Gjon Berisha - <i>sekretar shkencor</i>				
NGA/OD/FROM:	Prof. dr. Sabit Syla, <i>drejtor</i>				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport vjetor i punës - 2021				
Nr. i zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. kancelarije:		Kucni:	Instituti i Historisë	Datum:	28/12/2021
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					X
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					X
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					X
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

*E nderuara, znj. Arbërie Nagavci,
Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës*

Në kuadër të veprimtarisë themelore të Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë (më pas IHP), për rezultate të punës kërkimore - shkencore, në pajtim me Projektligjin, Ligjin dhe me Statutin, po u dërgojmë Raportin Vjetor të Punës për vitin 2021.

1. VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Bazuar në planin e punës për vitin 2021 veprimtaria e IHP është orientuar në disa drejtime:

1.2. Organizimi i konferencave dhe sesioneve shkencore

Gjatë vitit në 2021 IHP ka organizuar disa konferenca shkencore, të cilat krahas shënimit të disa ngjarjeve historike kishin për qëllim edhe sjelljen dhe prezantimin e rezultateve dhe njohurive të reja në fushën e historiografisë shqiptare dhe më gjerë:

- Në përvjetorin e 40-të të Demonstratave të vitit 1981, IHP organizoi më 10 qershor 2021 Konferencën shkencore, në të cilën punimet e tyre rreth tematikës së mësipërme i paraqitën rreth 30 studiues nga trevat shqiptare e më gjerë. Kumtesat e paraqitura në këtë sesion u karakterizuan nga qasja shumëdimensionale, këndvështrimet dhe teoritë moderne në hulumtime shkencore lidhur me këtë Lëvizje që përkujton një kthesë të rëndësishme në historinë e re të Kosovës dhe të kombit shqiptar në përgjithësi.

- IHP, në cilësinë e bashkë-organizatorit me Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë dhe Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Republikës së Kosovës, bashkë-organizoi më 25-28 nëntor 2021 në Tiranë Kuvendin e III-të të Studimeve Albanologjike. Rreth 182 studiues, shqiptarë dhe të huaj, për tri ditë rresht me dy seanca paralele paraqitën prurjet e tyre në shkencat: histori, gjuhësi, antropologji dhe studime letrare.

2. VEPRIMTARIA BOTUESE

Veprimtaria botuese e IHP konsiston në botimin e monografive, përmbledhjeve studimore, botimeve dokumentare, punimeve të ndryshme, akteve të kumtesave nga konferencat apo sesionet shkencore, që përgjithësisht janë rezultat i punës kërkimore-shkencore jo vetëm të studiuesve të IHP, por edhe më gjerë.

Në vazhden e botimeve nga fushat e cekura më sipër, vetëm gjatë vitit 2021 u botuan rreth dhjetë tituj, kurse një varg titujsh tjerë janë në procedurë vlerësimi të brendshëm. Ndër titujt e botuar apo në procedurë botimi, numërojmë:

(1) *Kosova gjatë mesjetës*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021;

(2) *Kosova: aspekte të jetës politike në Kosovë gjatë viteve 1968-1990*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021;

(3) *Perspectives on ideology and violence in the Second World War in Kosova*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021;

(4) *Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë* (Materiale nga Konferenca shkencore: “Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë”, 40-vjetori. Mbajtur në Prishtinë, më 10 qershor 2021), Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021;

(5) *Vendosja e sistemit të Timarit në Kosovë në gjysmën e dytë të shekullit XV*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021;

(6) *Shqipëria dhe shqiptarët sipas dokumenteve ushtarake gjermane 1943-1944 : (dokumente)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021;

(7) *Studime historike I : (studime, kumtesa, vështrime dhe recensione)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021;

(8) *Kuvendet ndërballkanike dhe shqiptarët gjatë shekujve XVI-XVII*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021;

(9) *Pozita e shqiptarëve në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore: 1941-1945*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021;

(10) *Çështja e shqiptarëve në Jugosllavi në sfondin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë 1918-1939*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2021.

Revista:

Revista shkencore “Kosova” është organ i Institutit të Historisë në Prishtinë që botohet në baza vjetore. Me një traditë më shumë se dyzetvjeçare të botimit, me një redaksi nga ekspertë të fushave të ndryshme historike, numri 46 i revistës “Kosova”, përmban artikuj nga tematika të ndryshme që janë fryt i punës kërkimore-shkencore, kumtesave nga konferencat shkencore, materialeve dhe recensioneve, e që ngërthejnë në vete aspekte nga periudha të ndryshme historike.

3. HULUMTIMET SHKENCORE NË ARKIVA NDËRKOMBËTARE DHE REALIZIMI I PROJEKTEVE

a) Projektet hulumtuese në arkiva

Gjatë këtij viti studiuesit e IHP kanë qenë të kufizuar në punën hulumtuese në arkiva vendore e ndërkombëtare, për shkak të pandemisë. Megjithatë, ata nuk i ndërprejnë tentativat. Hulumtime të kufizuara, sipas rrethanave, u kryen në: Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës; në arkivat e Shqipërisë (Arkivi Qendror i Shtetit; Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë; Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, etj.) dhe në arkivat e Kroacisë.

b) Pjesëmarrje të studiuesve në konferenca kombëtare e ndërkombëtare

Në mënyrë individuale, studiuesit e IHP kanë marr pjesë në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare lidhur me tematikat nga periudhat e ndryshme historike, sikurse: “Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë” organizuar nga Instituti i Historisë në Prishtinë (qershor 2021); “Kongresi arsimor i Lushnjës dhe gjuha shqipe” organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës (tetor 2021); “Ballkani midis integritit evropian dhe bashkëpunimit rajonal” organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të shqiptarëve - Shkup (tetor 2021); dhe “Kuvendi i III i studimeve Albanologjike” në Tiranë (nëntor 2021), etj.

c) Botime shkencore në revista kombëtare e ndërkombëtare

Punën e tyre shkencore, studiuesit e IHP e kanë prezantuar në disa revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare si në: *Kosova, Studime Historike, Albanian Studies, Gjurmime Albanologjike, Studime Shoqërore, Iliria, Journal of Balkan Studies, Rumeli Journal of Islamic Studies, Historical Research, Journal of History and Future, Albanologjia, Journal of Danubian Studies and Research*, etj.

4. PROJEKTET SHKENCORE KOLEKTIVE

Në aspekt të projekteve shkencore kolektive, i gjithë fokusi i IHP gjatë vitit 2021 ishte vazhdimi i hartimit dhe redaktimit të projektit shkencor “Historia e Kosovës” në katër vëllime. Në këto vëllime janë angazhuar shumica e studiuesve shkencorë të IHP në cilësinë e autorit, redaktorit apo mbështetësit shkencor. Aktualisht, materialet e të katër vëllimeve gjenden në fazën e redaktimit shkencor. Vëllimet e tekstit Historia e Kosovës, të cilat përfshijnë periudhën nga parahistoria deri në vitin 2008, do të jetë e para histori e Kosovës e punuar me kritere shkencore nga studiues kompetent të periudhave specifike të historisë. Si të tilla, këto tekste do të sjellin risi të shumta në metodologji, në stilin e shkrimit, në burimet referuese dokumenteve arkivore, si dhe analizën objektive shkencore.

Gjatë këtij viti IHP ka vazhduar edhe me projektin e dytë kolektiv: “Gjenocidi serb në Kosovë, 1877-1999”. Në këtë projekt, është punuar në fazën e mbledhjes së të dhënave sipas komunave të Kosovës, kurse një pjesë e studiuesve do të angazhohen edhe në hartimin dhe analizimin e këtyre të dhënave.

Gjithashtu, dy studiues nga IHP filluan angazhimin në projektin “Historia e shqiptarëve”, projekt i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.

5. ARKIVI DHE BIBLIOTEKA E INSTITUTIT TË HISTORISË

IHP posedon arkivin dhe bibliotekën e tij, të cilat parimisht janë në dispozicion jo vetëm të studiuesve të Institutit, por edhe më gjerë. Duke pasur parasysh se arkivat dhe bibliotekat paraqesin një rol thelbësor në mbarëvajtjen dhe avancimin e punës shkencore-kërkimore, gjatë vitit 2021 IHP i ka kushtuar një vëmendje të veçantë rregullimit, sistematizimit, regjistrimit dhe plotësimit me materiale të këtyre dy subjekteve.

(1) Arkivi i Institutit të Historisë

Duke qenë se në kuadër të projekteve të IHP-së studiuesit kanë qenë të obliguar që një pjesë të materialeve nga hulumtimet e tyre ta depononin në Arkivin e Institutit, ndërsa ky i fundit gjatë vitit 2021, por edhe më herët, ka arritur ta krijoj një fond prej qindra mijëra dokumentesh burimore të vjela nga arkivat e botës: të SHBA-ve, të Britanisë së Madhe, të Gjermanisë, të Francës, të Italisë, të Austrisë, të Turqisë, të Bullgarisë, etj.

Pasi që materiali dokumentar ishte deponuar në Institut përmes pajisjeve elektronike (USB), pas vlerësimit u konstatua se shtypja (printimi) do të ishte një metodë që do të parandalonte humbjen e tyre si rezultat i avarive teknologjike (viruseve), deri në krijimin e një programi (softueri) adekuat nga fusha e teknologjisë informative. Si rezultat, janë shtypur diku rreth 140 përmbledhje (në formë libri) me burime historike (mesatarja nga 1000 faqe secila), kurse edhe 40 tjera janë në proces botimi. Këto përmbledhje do të vihen në dispozicion jo vetëm të studiuesve të IHP, por edhe më gjerë.

Një nga risitë e këtij viti lidhur me pasurimin e fondit arkivor ishte edhe sigurimi i materialeve nga studiues që materialet burimore të grumbulluara përgjatë viteve t'i vinin në dispozicion Arkivit të Institutit. Në këtë mënyrë Instituti siguroi një fond të çmueshëm arkivor për historinë tonë kombëtare dhe me gjerë.

(2) Biblioteka e Institutit të Historisë

Biblioteka e Institutit të Historisë në Prishtinë posedon një fond voluminoz librash, përmbledhje dokumentesh, gazetash, revistash dhe të materialeve tjera të formës së shtypur dhe atë në gjuhën shqipe, serbokroate, maqedonase, turke, angleze, gjermane, etj. Gjatë vitit 2021 në kuadër të Bibliotekës u ndërmor iniciativa për riorganizimin e saj. Ky akt nënkuptonte evidentimin, klasifikimin, sistematizimin dhe regjistrimin e inventarit sipas koncepteve të reja të bibliotekarisë dhe vënien e tyre në një program kompjuterik që brenda një kohe të shkurtër do t'u vihet në dispozicion studiuesve të Institutit.

6. ANGAZHIME TË TJERA

Studiuesit e Institutit të Historisë në Prishtinë në mënyrë intensive janë angazhuar edhe në emisione televizive, dokumentare, në prononcime në medien e shkruar dhe elektronike, duke iu përgjigjur interesit të opinionit publik për çështje të ndryshme me natyrë historike.

7. PRIORITETET PËR VITIN 2022

Krahas punës kërkimore-shkencore individuale dhe kolektive prioritetet e IHP-së në Prishtinë gjatë vitit 2022 do të orientohen në drejtim të:

1. përfundimit të vëllimeve “Historia e Kosovës”, në kuadër të projektit shkencor të Institutit të Historisë në Prishtinë;
2. realizmin e projektit (shkrimin e tekstit) “Gjenocidi serb në Kosovë, 1877-1999”;
3. realizmin e tekstit sintetik “Historia e shqiptarëve”, projekt në kuadër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë;
4. në përgatitjen e një cikël vëllimesh dokumentare;
5. në bashkëpunim me Institutin e Historisë në Tiranë, synohet përgatitja e një reviste të re të përbashkët studimore në gjuhën angleze;
6. në organizimin e konferencave shkencore për tematika dhe data të veçanta;
7. në zgjerimin e bashkëpunimit me institucione kërkimore-shkencore e universitare kombëtare e ndërkombëtare, duke synuar konferencave, botime kërkime të përbashkëta; etj.
8. pasurimin e Arkivit të IHP dhe mundësisht sigurimin e një softueri adekuat për ruajtjen dhe përdorimin e materialeve arkivore;
9. pasurimin e Bibliotekës së IHP me tituj të ri, mundësisht botime ndërkombëtare nga studiues të shquar të historisë;

8. VËSHTIRËSITË

Në vazhden e realizimit të veprimtarisë së tij IHP është ballafaquar me dy probleme serioze:

(1) *Pandemia* - kufizimi i lëvizjes dhe qasjes së lirë në institucione, arkiva, dhe biblioteka gjatë vitit 2021, ka ndikuar në ngadalësimin dhe vështirësimin e aktiviteteve punuese, sidomos në projektet jashtë Republikës së Kosovës;

(2) *Objekti i punës* - në objektin e IHP funksionojnë zyrat e administratës së Universitetit të Prishtinës, kurse studiuesit e IHP qëndrojnë në zyrat që gjenden në Agjencinë e Arkivave të Kosovës. Kjo e fundit, që një kohë insiston në lirim të zyrave nga Instituti, ndërsa IHP kërkon lirim të objektit të tij nga Universiteti i Prishtinës. Universiteti i Prishtinës posedon hapësira të shumta pune të shtrira në 14 njësi akademike apo ndërtesa, shumica prej të cilave janë të zbrazëta.

Funksionimi në dy ndërtesa e vështirëson punën dhe veprimtarinë unike të Institutit të Historisë. Duhet cekur faktin se IHP dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës qysh një kohë të gjatë angazhohen pranë institucioneve të Republikës së Kosovës për zgjidhjen e këtij problemi të përbashkët.

Prof. dr. Sabit Sylja, drejtor